AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Mirëqenies Sociale, Dhjetor 2023

23.01.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin dhjetor 2023.

Rritet skema për pensionet paraplegjik dhe tetraplegjik në dhjetor 2023, krahasuar me dhjetor 2022

Në muajin dhjetor 2023, nga skema për pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike kanë përfituar 3 006, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak që ishte 2 542 perfitues, vërehet një rritje prej 18,3%.

Numri i përfituesve nga skemat pensionale dhe skemat e tjera të mirëqenies sociale

Përfituesit e pensioneve dhe skemave tjera sociale	Muaji/Viti		12.2023/ 12.2022
	12.2022	12.2023	
Skema e ndihmës sociale	22 980	20 379	-11,3%
Pensionet bazike të moshës	144 015	149 967	4,1%
Pensionet kontributpaguese të moshës	48 428	48 783	0,7%
Pensionet e personave me aftësi të kufizuara	19 419	20 616	6,2%
Pensionet e Trepçës	1 736	1 412	-18,7%
Pensionet e Forcave të Sigurisë së Kosovës	699	770	10,0%
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës	1 281	1 322	3,2%
Skema e të verbërve	1 855	1 893	2,0%
Pensionet Familjare	3 304	2 945	-10,9%
Pensionet e Invalidëve të punës	60	47	-21,7%
Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike	2 542	3 006	18,3%
Skema e kompensimit për punëtorët e arsimit për vitet 90/91 deri në 98/99	12 878	13 639	5,9%
Pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës	13 067	12 877	-1,5%
Veteranët	36 825	36 875	0,1%
Skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara	2 921	3 303	13,1%

Rënie e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin dhjetor 2023, krahasuar me muajin dhjetor 2022, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalidore (-21,7%); skema për pensionet e Trepçës (-18,7%); skema e ndihmës sociale (-11,3%) skema për pensionet familjare (-10,9%); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,5%).

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Rritje e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin dhjetor 2023, krahasuar me muajin dhjetor 2022 kishte rritje të numrit të përfituesve nga: skema për mbështetje materiale familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (13,1%); skema e pensioneve për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) (10,0%); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (6,2%); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5,9%); skema e pensioneve bazike të moshës (4,1%); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (3,2%); skema e kompensimeve për personat e verbër (2,0%); skema e pensioneve kontribut-paguese të moshës (0,7%); skema për veteranët e luftës (0,1%).

Për më shumë informata lidhur me Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin dhjetor 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/SocialWelfare